



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **19.03.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                       |                                    |
|---------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u>          | 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u>    |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u>        | 15. <u>Ajshe Metaj, AAK;</u>       |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u>         | 16. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u>     |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u>         | 17. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u>       |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u>          | 18. <u>Florin Dreshaj, VV;</u>     |
| 6. <u>Ruzhdi Metaj LDK;</u>           | 19. <u>Niman Beqiraj, VV;</u>      |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u>            | 20. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajci Avdiaj, LDK;</u> | 21. <u>Lavdiqe Bujupaj, VV;</u>    |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u>         | 22. <u>Arian Shatri VV;</u>        |
| 10. <u>Njomza Demaj, LDK;</u>         | 23. <u>Andi Xhuraj PDK;</u>        |
| 11. <u>Agron Gashi, AAK;</u>          | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u>        |
| 12. <u>Arianit Selmanaj AAK;</u>      | 25. <u>Melis Smakic;</u>           |
| 13. <u>Nexhmedin Balaj, AAK;</u>      |                                    |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i Komunës Ilir Ferati, Nënkyetari i komunës Ali Nimanaj, Nënkyetari i komunës për Komunitete Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=P64dtaWeV-Y>

[https://www.youtube.com/watch?v=h4N8nc5R\\_Xc](https://www.youtube.com/watch?v=h4N8nc5R_Xc)

: "shembulli 3").

Procesverbali

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

**Kryesuesi i Kuvendit**- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Hap punimet për mbledhjen e Jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të mbledhje e cila është thirrur nga dymbëdhjetë këshilltarë të Kuvendit materialin e keni dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

**Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 25 të anëtarë të Kuvendit.**

Vazhdojmë me mbledhjen :

## R e n d d i t e

1. Informata nga Kryetari i Komunës dhe Nënkyetari për Komunitete, për vizitën e fundit nga klerikët e kishës ortodokse serbe në vendin arkeologjik “Bregu i Kishës” në fshatin Studenicë të cilët përquan mesazhe politike dhe tensionuan situatën tek banorët e qytetit.

### Shqyrtimi i pikës 1

**Kryesuesi i Kuvendit**- a ka dikush sugjerime në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Fjalën e ka Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi**- përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë e kisha pasur një vërejtje rreth thirrjes së kësaj mbledhje, ku përfshihet që ne raport të jetë edhe nënkryetari i komunës për Komunitete, ku një raport e bën kryetari, nuk e besoj që duhet të jetë edhe nënkryetari. Një vërejtje e kisha dhënë edhe në lidhje me thirrjen e kësaj mbledhje ku iniciuesit e kësaj mbledhje nuk i kanë thirrur të gjithë anëtarët e Kuvendit që të nënshkruhen për thirrje të mbledhjes, pasi që nuk është çështje e partive politike as e individëve as e Kuvendit, besoj që është çështje më e ndërlikuar, është brengë e të gjithëve edhe e Kryetarit edhe e ekzekutivit edhe e qytetarëve, prandaj do ishte dashur që të ju ofrohet të gjithë anëtarëve të Kuvendit që të nënshkruhen. Kisha kërkuar që të hiqet prej raportit nënkryetari për Komunitete.

**Kryesuesi i Kuvendit**- ajo nuk mund të hiqet Hajrush, nuk mund të ndërhyjë në rendin e ditës. Fjalën ja japi kryetarit të Komunës.

**Kryetari i komunës**- përshëndet të gjithë të pranishmit! Për hirë të vërtetës dhe korrektësisë ligjërishit unë si kryetar dhe ekzekutivi nuk jemi të obliguar që të japim kësi lloj raporte para Kuvendit moralisht dhe politikisht për shkak të situatës së krijuar, për këta sot jemi bashkë që ta sqarojmë secilën dilemë që çdo kuvendar apo qytetar mundet me e pasur në raport me situatën që është krijuar me datën 04.03 2024. Situatë që na ka prekur të gjithëve e sidomos banorët e fshatit Studenicë për të cilët kemi respekt të madh si ekzekutiv për shkak të së kaluarës e në cilat periudha ata kanë dëshmuar vetën në secilën formë që ky vend ka pasur nevojë për ta. Me datë 4 Mars, vizita e klerit të kishës ortodokse serbe është bërë pa njoftim të

organeve komunale. Policia e Istogut informacionin e ka marrë rreth orës 13.40 min dhe rreth orës 14:10 min ka dalur në vend të ngjarjes gjatë rrugës për te Bregu i Kishës janë përballë kaluar me dy vetura të EULEX-it dhe në momentin që kanë arritur te Bregu i Kishës nuk ka qenë askush. Pas kësaj kemi parë video të skenave që kanë qenë të rënda. Përtej kësaj EULEX-i ka dalur me një deklaratë që gjoja e paska njoftuar nënkryetarin e komunës për Komunitete z.Rama, që vizita do të ndodhë në fshatin Studenicë edhe për ditën edhe për orën deklaratë që nuk qëndron absolutisht fare. EULEX-i ka kërkuar përmes z.Rama para një muaji nëse nuk gaboj në kohën kur është bërë rrethoja si të gjitha institucionet tjera që përfaqësohen prej ndërkombëtareve me bërë një takim me kryetarin dhe me e diskutuar temën që e kemi diskutuar edhe me KFOR-in me OSBE e me të gjithë akterët ndërkombëtarë. Takimi nuk është mbajtur sepse ata e kanë shtyer për arsye të tyre. Kjo ka qenë e vetmja herë kur ata janë takuar me z.Rama. Për të mos u ndalur me kaq, përpos që ne nuk kemi qenë të informuar as Policia e as KFOR-i. Vizita është organizuar prej EULEX-it. Nuk e dimë prej cilit nivel komandues apo drejtues, i vetmi informacion që e kemi është që i kanë dërguar ata klerikë në kishë dhe i kanë kthyer. Fatmirësisht, për të mos u prodhuar një situatë që pastaj kishte me prodhuar efekte apo pasoja që nuk do kishim mundur t'i kontrollonim. Pas marrjes së informatës ne menjëherë kemi kontaktuar edhe Policinë, KFOR-in dhe OSBE-në, para këtyre i kemi takuar mos të gaboj në numër 18 përfaqësues të fshatit Studenicë dhe e kemi sqaruar me fjalë kështu si para juve. Në takimet me Policinë, KFOR-in dhe OSBE-në, i kemi ngritur shqetësimet tona e shqetësimet më të mëdha të fshatit Studenicë. Jemi deshmitarë të zhvillimeve të fundit të cilat nuk i bëjnë nder as shtetit të Kosovës, e as ne nuk bëjmë nder nëse tentojmë të prodhojmë për pak politikë ditore situata politike të cilave pastaj nuk e kemi në dorë ne dhe kalon në nivel, në të cilin nivel pastaj mundemi vetëm me respektuar vendime.

Kryetari lexon rezymenë e përgatitur.

Duhet të jemi të kujdesshëm në diskutimet tona, në raport me atë se çfarë po synojmë, është interes i gjithmbarshëm, nuk ka etiketë partiake e politike, e ka etiketën e qytetit të Istogut, të cilin qytet e përfaqësojmë secili prej nesh në forma të ndryshme përmes votës që e kemi marrë direkt prej qytetarëve. Duhet të kemi kujdes mos të bëjmë thirrje për urrejtje për tension, ata që kanë ardhur në fund të ditës e përfaqësojnë vetëm veten e tyre, dhe vizita e tyre nuk e tjetërson origjinalitetin e kishës të cilën e kanë të shenjtë edhe Studenica edhe ne. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit kryetar! Fjalën e ka kërkuar Agron Gashi.

**Agron Gashi-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Siç e thatë edhe më herët këtë seancë e kemi thirrur vetëm për informim, dhe kemi dashur të njoftohemi konkretisht nga kryetari dhe nënkryetari për Komunitete se çfarë ka ndodhur ditën e 4 Marsit pikërisht para Epopesë së Uçk-së. Kemi dashur të dimë, shkresat dhe diskutimet që janë bërë me zyrën e Komuniteteve të cilën e tha Hajrushit që nuk ka pasur nevojë, ne kemi pasur nevojë sespe gjithçka është sillur rreth asaj zyre, edhe kemi të drejtë ta dimë si të zgjedhur të këtyre qytetarëve se çfarë është diskutuar në ato takime. Thuhet që në ato takime është diskutuar për vizitën dhe faktikisht edhe për rrethojat, edhe me e ditë prej nënkryetarit pse është diskutuar për rrethojat, a është pikë dyshimi vendosja e tyre, a është pronë e jona apo duhet me e pyet dikë tjetër për me i vendosur ato. Pikë tjetër ka qenë diskutimi i vizitës tyre, a janë përmendur klerikët serbë në atë vizitë edhe nëse janë përmendur pa marrë parasysh kohën që po e thotë kryetari që nuk e kanë ditur kohën kur, faktikisht nuk është dashur të ju jepet leje, sepse persona të tillë janë të njohur për deklarata politike edhe pikërisht për atë çështje thirrur kjo seancë sepse kanë përçuar mesazhe politike, ata vetëm me sjellë mesazhe paqësore nuk vijnë në këto vende, sidomos në objektet tona që i kemi që e tha edhe kryetari që lexoj pak histori që ato objekte janë para se me ardhur ata prej vendeve ku kanë ardhur në Ballkan. Kemi të drejtë të informohemi dhe me e

ditur çfarë kemi pjesë tonën edhe me e ruajtur atë dhe me i mbrojtur edhe me e mbajtur sigurinë e qytetarëve si ne si kryetari. Pikërisht te siguria e komunës, ne e kemi thirrur këtë seancë e kemi parë që në vitin 2019 ka pasur tensione të mëdha e pikërisht janë ata njerëz që i kanë sjellë ato tensione, pastaj në komunikimin e vizitës së tyre është dashur me i diskutuar këto gjëra, kur e kemi Policinë e Republikës së Kosovës ne qytetarët nuk tensionohemi sepse gjithmonë klerikët serbë marrin pjesë në këto kisha që i kanë të tyre, por që ka pasur më herët tensione me ik kjo nuk është e mirë. E kisha ftuar kryetarin apo nënkryetarin me e ditur ato komunikime që janë bërë zyrtare edhe a janë përmendur klerikët atëherë që kanë me ardhur e vetëm nuk e kanë treguar datën, faktikisht është dashur mos me e lënë të vijë, objektet tona që kemi fakte dhe pretendojmë që janë tona me i lënë dikush prej një vendi tjetër me bërë rituale. Ky manastir siç e tha edhe kryetari është Paleokristian ka fakte shkencore për të. Kështu që nuk kemi nevojë t'i japim përgjegjësi askujt për objekte tona as për rrethoja, në fund të kësaj seance unë i kam disa rekomandime që kam për ti dhënë për me e mbrojtur atë monument dhe mos të vijmë deri te këto situata të pakëndshme që kanë ndodhur kohëve të fundit. Desha të lidhem me Hajrushin, këtë seancë e kemi thirrur për shkak të mos informimit publik ose mos dënimit të këtyre deklaratave që janë dhënë nga këta klerikë, sidomos kryetarit i ka takuar në një postim zyrtar apo në media me i dënuar këto deklarata politike sepse ne nuk kemi parë asgjë, dhe për faktin që nuk kemi parë asgjë e kemi thirrur këtë seancë, na është dashur neve opozitës me e thirrur sepse nuk ka reaguuar askush prej komunës zyrtarisht, ka pasur takime por kryetari komunës kur ndodhë diçka brenda komunës sidomos kur është fjala për siguri që tensionohen qytetarët e Istogut duhet me dalë me deklaratë zyrtare që i dënojmë në emër të qytetarëve këto deklarata, fyerje që po i bëhen qytetarëve të Istogut me diçka absurde në monumentet tona. I kam disa propozime por dua t'i jap më vonë, i them kryetarit që këto nuk janë politika ditore jemi të indinjuar si të gjithë qytetarët, kemi thirrur seancë informuese pa tensione pa asgjë, këtu ndoshta ka përfaqësues, edhe publiku nuk i ka ditur ato që i the ti, është mirë që i the, që i informove, edhe ne kemi të drejtë të bëjmë pyetje, dhe me e sqaruar situatën pa tensione shumë qetë. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i komunës.

**Kryetari i komunës-** faleminderit Agron! Deklarata publike në raport me vizitën, i kam pasur afër para Rtv Fontana të nesërmen e vizitës pas takimit me qytetarët e fshatit Studenicë, nëse nuk gaboj edhe ky kameraman që po xhiron tani këtë mbledhje ka qenë i njëjti nëse nuk gaboj. Kryetari është përgjegjës edhe për zonën e sigurisë, e në deklarata po flas për vete duhet të kemi kujdes se çfarë thirrje po bëjmë, që është dënuar ajo prej secilit akter të komunës nuk do diskutim. A janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme që situata të tilla mos të përsëriten më, as kjo nuk do diskutim në raport me të gjithë akterët që ne menaxhojmë jetën multietnike në Istog, ka qenë zonë e qetë dhe nuk ka pasur asnjëherë probleme të natyrës etnike ndonjëherë. Rrethoja është iniciuar prej fshatit Studenicë për shkak se e shohin si të shenjtë edhe ka pa filluar të kthehet në deponi të mbeturinave, prej diskutimeve të tyre me ta është prodhuar ideja që të qiten rrethojat, tel i thjeshtë ka qenë. Proceduralisht a kemi qenë pak neglizhent si komunë sepse është dashur me marrë leje prej një komuniteti ndërministror ashtu e thotë ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, ne leje ose pëlqim për secilin intervenim që e bën në zonat përreth ku ka mbetje arkeologjike, është vendosur 15-20 m në distancë ashtu siç e thotë ligji, janë kryer punë prej njerëzve që janë të licencuar që punojnë në vende arkeologjike. Nuk ka pasur intervenime në themele gjë që e ka pretenduar Akademia e Shkencave të Serbisë, ministria e kulturës së Serbisë, zyra në Serbi që është për Kosovë e të gjitha këto informacione janë shkarkuar në formë presioni për ne me pretendimin se ne kemi tentuar me ndryshuar përbërjen. Ideja ka qenë vetëm e konservimit edhe e të mbajturit pastër, dhe e qasshme me një

derë që ta lejon hyrjen, me një përshkrim që ka qenë i vendosur në hyrje, rrethoja fatkeqësisht më nuk është. Dy ditë mas vizitës nuk jam i sigurt, persona të pa autorizuar kanë shkuar e kanë bërë rrafsh me tokë. Te leja për vizitë unë e thashë, arsyeja që e kanë takuar nënkryetarin për Komunitete ka qenë kërkesa për takimin me mua për të ja u sqaruar situatën se çfarë ka ndodhur me vendosjen e rrethojës, absolutisht asnjë komunikim tjetër apo kërkesë për vizitë sepse zakonisht këto vijnë prej KFOR-it. Po ta kishim idenë e një vizite zyrtare informacioni do të vinte në polici me kohë, dhe policia do të mund të organizonte sigurinë e tyre që mos me prodhuar tension, apo situatë që nuk do kishim mundur me fal pastaj. KFOR-i do ishte prezent, ne do kishim qenë të informuar dhe kjo mbledhje nuk do ishte thirrur fare sepse do kishte pasur ecuri standarde. Nuk e thashë Agron që kjo është politikë ditore, por thashë të kemi kujdes mos të bëjmë politikë ditore, jemi dëshmitarë të ndodhive të fundit të cilat nuk kthehen më mbrapa e janë fakt për një mijë apo dy mijë vjet të tjera në këtë prespektivë e pata kërkesën për kujdes.

**Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.**

**Niman Beqiraj-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa i përket çështjes së ardhjes së klerikëve serbë në Studenicë sigurisht që nuk është pritur mirë meqenëse në këtë fshat ka ndodhur një masakër e tmerrshme nga forcat serbe siç edhe ne e dimë. Mirëpo te shohim se si është ligji dhe ta elaborojmë pak të shkojmë se si kemi ardhur deri te kjo vizitë në mënyrë që edhe banorët e Studenicës të informohen më në detaje, këto ditë prej thirrjes së seancës kemi pasur kohë edhe personalisht jam interesuar kam takuar disa ekspertë arkeolog meqenëse kemi marrë edhe informata, kisha pasur dëshirë me i ndarë përmes Kuvendit, në mënyrë që edhe qytetarët e Studenicës me e parë. Në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura që është miratuar në vitin 2008 në udhëheqjen e atëhershme të koalicionit PDK-LDK po e citojmë qëllimin e ligjit : ky ligj do të siguroj mbrojtjen e manastireve ortodokse serbe, kishave, vendeve të tjera fetare si dhe vendeve historike e kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb si dhe komunitetet tjera nëpërmjet themelimit të zonave të veçanta të mbrojtura. Në këtë ligj përpos tjerash në nenin 7.4 është listuar edhe manastiri i Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosnos Istog ose siç e njohim ne Bregu i Kishës apo edhe me emra të tjerë 'Kisha e Belit e Golanit. Sipas këtij ligji, para se të kryhen aktivitete kufizuese të tilla si ndërtime, zhvillime komerciale, apo edhe pastrimi i rrugëve, komuna përkatëse në këtë rast komuna e Istogut duhet të kërkoj marrëveshje me kishën ortodokse serbe, nëse nuk arrihet kjo marrëveshje palët do ja referojnë çështjen Këshillit për Zbatim dhe Monitorim. T'i citojmë disa nga obligimet që dalin nga ky ligj: gjatë vitit 2008 kur është listuar lista e zonave të veçanta të mbrojtura ky manastir ku ruhen gjurmët e periudhës antike ka qenë komplet e jona. Pyetja është si është lejuar ky monument të radhitet në listën e vendeve fetare të një rëndësie të veçantë për komunitetin serb. Para se të vazhdojmë duhet ta theksojmë se ministër i Kulturës në atë kohë në vitin 2008 ka qenë Skënder Hyseni prej LDK-së e që tani Studenica e krejt Istogu po i vuajnë pasojat e veprimeve të tij. Gërmadhat e manastirit të Virgjëreshës së Shenjtë gjenden në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, te kategoria trashëgimia arkeologjike e cila mbrohet përmes ligjit për Trashëgimin Kulturorë. Tani me u rikthyer në vitin 2024 ku në janar të këtij viti mediat kanë reportuar për ndërhyrje pastrimi dhe rrethimi në manastir apo siç e quajmë ne Bregu i Kishës, pas reagimeve nga KFOR-i jemi informuar se këto ndërhyrje janë realizuar pa pëlqim dhe leje, duke i anashkaluar kështu institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore respektivisht Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Pejë dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës. Thënë ndryshe kryetari e ka shkel Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Ligjin për Trashëgiminë Kulturorë për poena puro politikë, se kur ka qenë koha me e mbrojtur në vitin 2008 faktet historike kanë treguar që nuk ka qenë kishë serbe dhe

nuk ka pasur serbë aty, janë përkujdesur që edhe emrin me ja lënë serb e jo siç quhet Bregu i Kishës. Reagimet e mëtejme sikurse vizita e klerikëve serbë dhe reagimet e qytetarëve fatkeqësisht vijnë si rezultat i ndërhyrjes pa konsultim paraprak me institucionet përgjegjëse për trashëgimi kulturore dhe pa u pajisur me pëlqim të tyre. Me pak fjalë klerikët serbë i ka sjellë komuna për shkak të paaftësisë së tyre për me marrë një leje.

**Kryesuesi i Kuvendit-** ju kisha lutur që mos të dalim prej teme Niman. Kjo është çështje e të gjithëve nuk ka të bëjë me parti politike. Mos t'i japim karakter politik kësaj çështje. Fjalën e ka Agron Gashi.

**Agron Gashi-** kam pyetje prej shumë qytetarëve pse kjo mbledhje nuk është transparente, direkt?

**Kryesuesi i Kuvendit-** pasi që është në defekt, kjo mbledhje do të transmetohet nga fillimi pa shkurtesa. Pasi të rregullohet për 10 minuta vazhdojmë mbledhjen.

**Vazhdon mbledhja.**

**Kryesuesi i Kuvendit** -fjalën e ka Floriana Maxharraj.

**Floriana Maxharraj-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Para dy mbledhjesh kam shprehur shqetësimin e banorëve të fshatit Studenicë lidhur me rrethojat në "Bregun e Kishës" dhe pyetja ime ishte se nga kush janë vendosur ato rrethoja dhe a ka pasur leje për vendosjen e tyre. Përgjigjja nga ekzekutivi ishte se ka pasur leje rrjedhimisht janë vendosur ato, ani pse nuk ka pas një leje të tillë. Pas vizitës së klerikëve serbë në "Bregun e Kishës" shqetësimet e banorëve veçse janë shtuar dhe janë disa arsye për këtë shqetësim: 1. Pse komuna nuk ka dalë me një sqarim lidhur me atë vizitë, të tregoj arsyet e dhënies së lejes siç është deklaruar EULEX-i, por për shkak të mosreagimit të tyre kanë krijuar huti e mllëf tek qytetarët, duke çuar kështu në një situatë aspak të lakmueshme dhe duke i vendosur para një akti të kryer ku do kishin mundur të bënin veprime sikur në të kaluarën, 2. A është pikërisht veprimi juaj që duke rrethuar "Bregun e Kishës" të jetë shkak për një vizitë të tillë? Qytetarët kërkojnë transparencë nga ju, ata thjeshtë duan ta kuptojnë situatën ashtu siç është. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit! Fjalën e ka Kryetari i komunës.

**Kryetari i Komunës-** Florianë, kisha është në Istog, në zone kadastrale të komunës së Istogut, sa kam informacion nuk ka asnjë institucion që ka kërkuar leje prej Komitetit e që ai Komitet ka arritur të mblidhet ndonjëherë, ishte dashur ta keni edhe këtë informacion ju, njëherë mungon i ministrisë, njëherë i OSBE-së, njëherë i kishës edhe Komiteti nuk ka arritur të mblidhet asnjëherë. Rrethojë është nuk është mur, rrethojë që është bërë me kërkesë të banorëve të Studenicës. Paralel me të është pastruar prej vegjetacionit edhe ajo në Vrellë, paralel me të është pastruar edhe muri i Kalasë Bizantine që është mbi fshatin Cerrcë, të gjitha janë asete arkeologjike të komunës së Istogut. Rrethoja është bërë që mos të kthehet në deponi, nuk e di sa herë e keni vizituar para së të bëhet rrethoja, nuk është rrethuar ajo që me ja u jap atyre mundësinë me e bërë vizitën, pati ose jo rrethoja, kur vijnë me KFOR-in ata e bëjnë vizitën. Unë i kam pas në zyrën time 17-18 banorë të fshatit Studenicë ku gjithsecili e ka minimalisht një anëtar të vrrarë në luftën e fundit, po flas për civil, gra, fëmijë ,pleq nuk janë gjëra të lehta me i përballuar, të cilët po shfrytëzojnë rastin thjeshtë me i falënderuar nivelin e lartë të

qytetarisë të treguar edhe në komunikim me mua me OSBE-në dhe KFOR-in. Pretendimet e Nimanit, situata e vitit 2004 gjithsecilit prej jush ju kujtohet, para se të ndodhnin në fillimet e vitit 2004, kisha ka pasur kërkesë në UNESCO për me ardhur edhe me i vlerësuar zonat të cilat ata i konsiderojnë të tyre edhe me i futur në zona të mbrojtura për shkak se ajo ka konsideruar që janë të rrezikuara. UNESCO ka krijuar Task-Forcë, dhe kjo e ka vizituar Kosovën edhe është dalur në të gjitha pikat ku ata kanë pretenduar që janë të rrezikuara dhe i kanë vlerësuar si jo të rrezikuara. Një vend që ka dalur nga lufta, monumentet fetare prej anës tonë kanë qenë të paprekuara, askush nuk ka shkuar me ja fut flakën një kishë, është raport zyrtar i UNESCO-s. Është krijuar situata në vitin 2004 e dimë se çfarë ka ndodhur pa e përmendur në detaje, situatë që e ka prodhuar kërkesën e dytë prej kishës me kërcënimin që UNESCO ka me u paditur ndërkombëtarisht në Gjykatë Ndërkombëtare për mos reagim. Kanë ardhur me të njejtën Task-Forcë edhe e kanë bërë vlerësimin tjetër edhe kanë gjetur situatë tjetër. Ajo situatë e ka futur atë që Nimani po e quan Skënder Hyseni me e fut në Ligj për Zona në 2008. Ai ligj është votuar në vit të Pavarësisë së Kosovës, shtet që është i të gjithëve pa dallim të gjinisë etnisë partisë ,se është votuar i tillë prej deputetëve të zgjedhur të këtij populli. Nuk duhet me i dhënë ngjyrim politik.

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit kryetar! Fjalën e ka Negjdet Ramaj.

**Negjdet Ramaj-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Në bazë të regjistrit kadastral të komunës së Istogut, për token që po flasim në vitin 1995, pushteti i dhunshëm i Millosheviqit këtë pronë nga prona komunale ja kalon kishës. Është mirë që mos të kalohet në heshtje kjo çështje, sepse në heshtje munden ta përvetësojnë. Pyetja ime është, pse, administrata komunale e Istogut asnjëherë pas luftës nuk ka marrë iniciativë për me i hudhë poshtë këto vendime të Millosheviqit pasi që në kohën e UNMIKU-t, këto vendime janë cilësuar si të jashtëligjshme, pasi që janë marrë në masa të dhunshme, dhe kërkojmë zyrtarisht që të fillojë në procedurë për anulimin e vendimeve të viteve të 90-ta. Dihet në fshatin Studenicë, për këtë kjo ka marrë bujë të madhe dhe është bërë mediale kjo tema e vizitës së klerikëve, pasi që në fshatin Studenicë paramilitarë serbë të dirigjuar nga Millosheviqi kanë masakruar shumë civilë gra të moshuara, pleqë dhe vajza ndër to edhe Lindihana 12 vjeçare. Nga ky Kuvend ju bëjmë thirrje strukturave të sigurisë dhe atyre që ishin të involvuar në vizitën e fundit që kurrë mos të përsëritet ky gabim pasi që banorët ende i kanë plagët e hapura dhe ajo pronë ka qenë dhe do jetë shqiptare. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Negjdet. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-**unë nuk pata dëshirë që me u kthyer prapë te ato se çfarë i thashë më herët, mirëpo Skënder Hyseni, që e përmendi prapë kryetari, nuk e ka futur në zonë të veçantë të mbrojtur por e ka dhënë në vend të rëndësie të veçantë për komunitetin serb, pra me e fut në zonë të mbrojtur p.sh si janë xhamiat, edhe atë d.m.th ja keni dhënë ju, edhe manastirin e Deçanit ja keni falur ju. Vet fakti që e ke shkelur ligjin, ke ndërtuar rrethojë, ke dhënë shenja te ndërkombëtarët që është duke u rrezikuar manastiri. Prapë po bie në kundërshtim me fjalët tua që i ke thënë. E ke ndërtuar rrethojën pa marrë leje pa marrë pëlqim, tani po na vijnë të gjithë në kishë. Këtu është problemi.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i komunës

**Kryetari i Komunës-** që e kam ndërtuar rrethojën nuk jam pishman asnjë pikë. E kam ndërtuar sepse kam pasur kërkesë prej banorëve të fshatit Studenicë, edhe të gjitha pretendimet që kisha serbe bashkë me autoritetet tjera serbe ato janë rrëzuar në momentin që ndërkombëtarët e kanë vizituar vendin e ngjarjes, ka qenë fakt që nuk ke mundur ta fshehësh. Edhe e kanë parë që aty është një rrethojë me tel, e jo e mjeteve të rënda motorike siç i kanë pasur pretendimet, por është rrethojë që e mbron prej mbeturinave, e mbron prej njerëzve njerëzve që munden me pasur synim të keq në atë drejtim, po më vjen mirë që qenkeni respektues të madh të ligjit, sinqerisht është për lavdatë. Negjdet janë çështje që i kemi diskutuar në zyre. Vendimet e shumicës së pronave që sot i gëzon kisha janë të viteve 1989-1999 deri kur as përfaqësim në Kuvend as institucione lokale nuk ka pasur as prezencë të etnive tjera përpos serbëve, kanë pasur shumicë absolute edhe i kanë marrë vendimet. Është diskutuar qindra here që janë vendime të kontestueshme, por është iniciativë që duhet të merret në bashkëpunim me politikat e nivelit nacional. Janë instancat ndërkombëtare që hyn në lojë menjëherë. Dhe në respektim të të drejtave duhet të bëhen bashkë qeveri e komuna për të arritur një rezultat. Me e bërë një votim në Kuvend është procedurë shumë e thjeshtë, por me i dhënë efekt ligjor pastaj atij vendimi është pjesa e komplikuar që duhet të bëhet bashkërisht. Janë vendime politike edhe kur janë marrë kanë qenë politike. Pse nuk janë marrë në vitet e mëhershme e thashë situata e vitit 2004 që ja u ka krijuar faktin edhe kishës edhe ndërkombëtarëve për me ardhur deri te një inicim i një ligji të tillë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit kryetar! Floriana Maxharraj e ka fjalën.

**Floriana Maxharraj-** e pata një replikë për kryetarin, pasi që "Bregu i Kishës" është zonë e mbrojtur, ishte dashur me pasur leje për një rrethojë të tillë, nuk ka rëndësi çfarë rrethojave janë, po mendoj që në asnjë formë nuk duhet të thyhet ligji. Përveç kësaj unë jam banore e Studenicës dhe nuk mund të themi që nuk ka pasur huti përderisa nuk kemi pasur informacione edhe as kryetari as komuna nuk ka dalur me asnjë sqarim. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** pak po befasohem me Nimanin dhe me ju Floriana, mos me pa vënë rrethojën kishit thënë pse nuk e keni vënë, sepse është kërkesë e banorëve të Studenicës e kryetari e tha disa herë, tani që është vënë po thuani pse nuk keni kërkuar leje. Nuk ka kompetenca as policia e nivelit qendror as lokal. Ju lutem mos ta bëjmë kauzë politike. Nuk e dëgjova prej një këshilltari tani të bëjmë rekomandime apo lajmërim Institutit Arkeologjik të Kosovës, Institutit Historik të Kosovës si njerëz kompetentë profesionalë, Qeverisë së Republikës së Kosovës, Parlamentit të Republikës së Kosovës, dhe Ministrisë përkatëse që janë bartës të këtyre gjërave. Hajrush Shoshi e ka fjalën.

**Hajrush Shoshi-** unë vetëm desha një sqarim nëse mundem ta bëjë. Ministria e Rinisë Kulturës dhe Sportit vitin e kaluar në muajin e dhjetë e ka aprovuar listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme e cila është prej 06.10.2023 deri me 06.10.2024 me numër të protokollit 5123 2023-2 e datës 06.10.2023, këtu në mesin e shumë objekteve të trashëgimisë, me numër 30 është edhe gërmadhat e manastirit Hvosna antikë e vonë mesjetare Studenicë Istog. Nuk e di a ka pasur ndonjë informatë komuna e Istogut lidhur me këtë listë apo vendim që e ka marrë ministria e Rinisë Kulturës dhe Sportit prandaj moskomunikimi po na kushton dhe po na lë



pasoja te popullata jonë. Pasi që i potencoi të gjitha Nimani ishte dashur ta potencoj edhe këtë a ka ndonjë informatë më shumë nuk e di.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj-** është e vërtetë ajo çka po e thotë Hajrushu, se kjo lista e zonave të mbrojtura të përkohshme, mirëpo Hajrushu ishte dashur me e ditë se ka qenë drejtor 4 vite edhe ka qenë anëtar i Kuvendit për disa mandate dhe ajo listë bëhet për çdo vit. Ajo është listë që çdo ministër duhet ta bëjë se e ka obligim. Hajrushu po thotë që nuk ka pasur komunikim me komunën, problemi është që komuna nuk ka pasur komunikim me qeverinë, është dashur ta marrë lejen dhe nuk e ka marrë. Këtu është problemi.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Florin Dreshaj.

**Florin Dreshaj-** shumëçka që kam menduar të them për këtë temë edhe u tha, në fillim edhe kryetari e sqaroi pak, mendoj që kjo kishë i ka rrënjët thellë në origjinën civilizimin dhe kulturën tonë shqiptare, edhe tani po ndihem në siklet kur po duhet në këtë kohë me diskutuar për këtë temë, sipas hulumtimeve që i kemi bërë nëpër shënimet e pakta që i kemi për këtë kishë daton që kjo kishë është prej shekullit IV V dhe VI kur është ndërtuar të epokës tonë edhe e përmendi kryetari që dyndjet serbe kanë filluar në shekullin VII dhe nuk mund të jetë kishë serbe sepse ata nuk kanë qenë këtu. Pastaj vizita e klerikëve serbë, ne e dimë që qëllimi i tyre nuk ka qenë për rite fetare por për mesazhe politike, edhe e dimë që ashtu ndihen edhe qytetarët jo vetëm të Studenicës por të gjithë, pra e përmendi edhe kryesuesi që nuk është çështje vetëm e Studenicës, është aset kombëtar, nuk kufizohet vetëm në Kosovë por në tërë trojet shqiptare, edhe nuk kanë faj që janë të provokuar sidomos ata në atë zonë sepse ende është gjaku i freskët i fëmijëve i grave i pleqëve që janë vrrarë në ato zona edhe duke e ditur që ushtria serbe edhe paramilitarët serbë janë bekuar po nga këta klerikë për t'i kryer ato krime. Në disa takime që i kam pasur edhe disa kontakte përmes telefonit me qytetarë edhe të Studenicës edhe të tjerë në Istog duke u mundur me marrë informata për kishën, kanë dalur edhe disa kërkesa për komunën edhe për qeverinë normal, nuk mundemi mi ndarë, gabime e dimë që janë bërë jo vetëm tani, por prej kohës kur është ndërtuar kishë serbe mbi themelet e kishës shqiptare, po shprehem kështu, prej atëherë e deri sot në histori janë bërë gabime. Por me i lënë ato, duhet me u mundur me gjetur një zgjidhje edhe kërkesa e qytetarëve është që të bëhet një hulumtim nga arkeologë profesionistë tani e dimë që edhe teknika ka avancuar, për shkak se deri me tani thirrmi në raportet që i kanë bërë arkeologët serbë d.m.th datojnë prej vitit 1968-1970 aty diku edhe ne e dimë sa mundemi të ju besojmë atyre arkeologëve. Pos asaj ka ende qytetarë që janë dëshmitarë të asaj kohe kur janë bërë ato hulumtime ka pasur momente që kanë punuar aty edhe punëtorë shqiptarë, ka pasur momente që ka qenë diçka që nuk duhet me e parë shqiptarët dhe kanë punuar vetëm ata serbë. Kemi qenë të pushtuar prej tyre dhe kanë mundur të bëjnë çfarë të dojnë. Kërkesa e dytë e banorëve të Studenicës por edhe të tjerëve është që deri sa të kemi një raport profesional të këtij grupi të arkeologëve të anulohen të gjitha vizitat në atë kishë me qëllim që mos të vijë deri te ndonjë incident i mundur, për shkak se banorët e Studenicës siç janë shprehur nuk do të jenë tolerantë. Një pyetje e pata për drejtorin por po më duket që u përgjigj nga Negjdeti, dëshiroj të di saktësisht kjo tokë si është e regjistruar në kadastër? Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i komunës.

**Kryetari i Komunës-** faleminderit për diskutimin Florin! Është regjistruar me Manastiri i Studenicës (Vhostan) këtë titullar e ka prej vitit 22.01.1995.

**Florin Dreshaj-** për kërkesat që i parashtrova të qytetarëve të intervenojmë në qeveri nga Kuvendi nga komuna e Istogut që të bëhet një hulumtim, gjurmim arkeologjik nga arkeologë profesionistë dhe të anulohen të gjitha vizitat deri në një raport. Unë thashë që gabimet janë bërë prej kohërave shumë herët e deri më tani, faktet po flasin që është kishë shqiptare paleokristiane, pasi që i kemi faktet të bëhet një hulumtim i mirëfilltë, e dimë që ata kanë manipuluar me faktet, e lexoi edhe kryetari, ky është aset kulturor shqiptar jo vetëm i Studenicës edhe ne duhet me iniciuar diçka. Unë mendoj që ky është qëllimi kryesor i kësaj mbledhje, jo vetëm informimi ose me ja lënë fajin dikujt.

**Kryesuesi i Kuvendit-** mundemi të ulemi një grup prej të gjitha partive edhe me e bërë atë që së pari e thashë unë t'i bëjmë sugjerimet ose rekomandimet që i qet ky Kuvend, që janë edhe të kryetarit edhe ekzekutivit edhe të të gjithë neve edhe me i adresuar siç duhet te ata që janë kompetent. Fjalën e ka Agron Gashi.


**Agron Gashi-** ti i përmende disa propozime, rekomandime, unë i kam paraparë disa nga to, por e lashë në fund se ato nuk bëhen a u shtjerrë debati. Siç e përmenden edhe kolegët më herët është mirë me u marrë me këtë çështje. Aty ka ndodhë një dëm, kryetari tha që kemi marrë veprime për herë tjetër, ajo është dëmtim i pronës publike, është dëmtuar rrethoja. Prona është e jona, është në mbrojtje të veçantë, kemi fakte to bollshme të arkeologëve shqiptarë e jo serbë. Nëse e bëni një kërkim të lehtë në internet kisha paleokristiane janë mbi dhjetë në Shqipëri. Arkeologët tonë e kanë zbuluar edhe një varr që është sipas riteve paleokristiane d.m.th fakti më i madh. I kam disa rekomandime deri sa të zgjidhet ajo situatë, atë pronë duhet me e rregulluar dhe me e mbrojtur sepse nëse është e jona duhet me qëndruar prapa saj, kemi raste kur policët tonë i mbrojnë objektet kishtarë serbe, mundemi ne me e bërë një kërkesë me e ruajt edhe objektin tonë arkeologjik. Tjetra, rrethoja me u rregulluar, me vendosur kamera, është vend arkeologjik, i të njëjtit sistem është edhe Ulpiana veç që Ulpiana i ka të gjitha këto. Pastaj me komunikuar me ministrinë e linjës me e ngjallë atë monument, është monument historik me e fut edhe drejtoria e Kulturës në raportet e veta edhe pas një viti nxënësit e shkollave e kanë vizituar atë objekt e kanë punësuar drejtoria, kryetari një ciceron që flet për të, e bëjnë një mirëmbajtje, dhe neve nuk na vijnë momente të befasishme me ardhë ata kur të dojnë, kush do qoftë, pa e parë komuna ose shteti se çfarë po bëhet aty. Aty mund të dëmtohen edhe provat, mund të bëhet gjithçka kur ne nuk dimë. Ne duhet me dalë si shtet me investuar në atë objekt, besoj se të gjithë janë të pajtimit, e kemi parkun arkeologjik në Ulpianë që krejt Kosova, nxënësit e Prishtinës shkojnë nga një mijë persona në ditë, pse mos me e bërë ne një diçka që e kemi historike tonën por e lëmë ashtu në mëshirë të fatit. Duhet me i shtjerrë të gjitha mundësitë për ministrinë e linjës, Institutin Arkeologjik dhe me e parë se ku jemi, se ende nuk po e dimë a është e jona, a po duam ne të investojmë në të, a e kemi qit rrethojën, a duhet me kërkuar prej ndërkombëtarëve a prej ministrisë me e qit rrethojën. Kështu që të sqarohen këto gjëra, dhe me e kontrolluar gjendjen në atë pjesë. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit**

Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,  
E shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.  
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

**Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:42**

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**



**Kryesues i mbledhjes,  
Enver Rugova**

